

Takimi ne Shkup "Let the Justice Rule the Region"

Përfaqësues nga Drejtoria e Integritit dhe Negociatave pranë Ministrisë së Drejtësisë, më 19 tetor, morën pjesë në Konferencën Rajonale me fokus Grupimin 1- Themelorët, në kuadër të nismës së përbashkët të Lëvizjeve Europiane në Serbi, Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut - "Let the Justice Rule the Region", me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe përfshirjen e shoqërisë civile në proces. Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, fokusi i diskutimit ishte Shteti i së Drejtës dhe progresi i bërë së bashku me sfidat e përbashkëta, ku panelistët vleresuan nivelin e reformave dhe politikave të bëra në fushën e gjyqësorit, të drejtat e njeriut, sigurinë dhe transparencën. Takimi shërbeu për nxjerrjen e rekomandimeve drejtuar shoqërisë civile dhe institucioneve publike, por dhe për ndarjen e eksperiencës dhe praktikave më të mira mes vendeve të Ballkanit Perëndimor.

